Беше нагласено дека предизвици има и во спроведувањето на законската надлежност на градоначалникот за редовно известување на Советот за извршувањето на неговите надлежности во согласност со Статутот на општината или за спроведувањето на донесените програми и одлуки од Советот. Многу често, во такви ситуации Советот нема доволно информации и не може правилно да го насочува натамошното работење и квалитетно да ги спроведува своите надлежности. Посебно беше потенцирано дека доколку градоначалникот сака да го распушти Советот на општината, тој може да употреби законски механизми за тоа, а од друга страна пак, Советот нема никакви ингеренции за дејствување кога ќе се утврди неквалитетно работење на градоначалникот. Затоа беше нагласена потребата од утврдување на законски постапки за обезбедување на непречена комуникација на советниците со општинската администрација и со градоначалникот и обезбедување на независна поддршка од стручни лица за работењето на претседателот на Советот и советниците. Исто така, беа изнесени дилеми околу потребата за залагање за професионализација на функцијата претседател на совет, (по примерот на градоначалникот) за што е потребно иницирање промени во Законот за локална самоуправа.

### Me procedura të definuara ligjore deri në përmirësimin e komunikimit midis Këshillit dhe Kryetarit të komunës

U theksua se sfida ka edhe në zbatimin e kompetencës ligjore të kryetarit për të njoftuar rregullisht Këshillin për kryerjen e kompetencave të tij në përputhje me Statutin e komunës apo zbatimin e programeve dhe vendimeve të miratuara nga Këshilli. Shumë shpesh, në situata të këtilla, Këshilli nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe nuk mund të drejtojë siç duhet punën e mëtutjeshme dhe të kryejë kompetencat e tij në mënyrë cilësore. Posaçërisht u theksua se nëse kryetari dëshiron ta shpërndajë këshillin e komunës mund të përdorë mekanizmat ligjore për këtë, e në anën tjetër këshilli nuk ka kompetencë të veprojë kur konstatohet performanca e dobët e kryetarit. Për këtë arsye u theksua nevoja për vendosjen e procedurave ligjore për të siguruar komunikim të qetë të këshilltarëve me administratën komunale dhe kryetarin e komunës dhe për të ofruar mbështetje të pavarur nga personat profesional për punën e kryetarit të Këshillit dhe këshilltarëve. Gjithashtu u ngritën dilemat edhe për nevojën e avokimit për profesionalizimin e postit të kryetarit të këshillit (sipas shembullit të kryetarit), që kërkon inicimin e ndryshimeve në Ligjin për vetëqeverisjen lokale.





**Дефинирање на критериумите што треба ги да исполни еден кандидат за советник**

Како сериозен предизвик беа посочни седниците кои се пренесуваат јавно. Особено во такви ситуации советниците максимално ја злоупотребуваат говорницата за политички поени. Ова придонесува некои седници да траат и по 8 и 12 часа и целосно да ја нарушуваат работата на Советот на општината. Беше посочено дека е потребно воведување на законски дефинирани критериуми за кандидатите за советници, според кои политичките партии и граѓанските групи ќе ги утврдуваат своите гласачки листи.

Извршната директорка на ЗЕЛС ДушицаПеришиќ ја предложи можноста за изработување на еден унифициран деловник за работа на Советот на општината, во кој ќе бидат имплементирани предлози со кои може да се надминат или ублажат одредени предизвици изнесени на оваа седница на Комитетот. Таа потсети и за можноста за реализирање на средби на претседателите на советите од секој плански регион, како што тоа беше спроведено во претходниот период, со цел размена на искуства и утврдување на предлози за подобрување на работењето на општинските совети.

На седницата присуствуваа и претставници од УНДП, кои ги презентираа целите и активностите на проектот „Зајакнување на општинските совети - фаза 2", што се спроведува во партнерство со ЗЕЛС, преку кој може да им се даде и поддршка на некои од активностите на Комитетот на совети при ЗЕЛС. Беше посочено дека поддршката од ЗЕЛС е од особена важност за општинските советници.

**Definim i kritereve që duhet t'i plotësojë një kandidat për këshilltar**

Si sfidë serioze u përmendën seancat të cilat transmetohet publikisht. Sidomos në situata të tilla këshilltarët keqpërdorin maksimalisht foltoren për pikë politike. Kjo kontribuon që disa seanca të zgjasin 8 dhe 12 orë dhe të prishin plotësisht punën e Këshillit të komunës. U theksua se është e nevojshme vendosja e kritereve të përcaktuara ligjërisht për kandidatët për këshilltarë, sipas të cilave partitë politike dhe grupet qytetare do të përcaktojnë listat e tyre të votimit.

Drejtori ekzekutiv i BNJVL-së, Dushica Perishiq, propozoi mundësinë e krijimit të procedurës së unifikuar për punën e Këshillit të komunës, në të cilën do të zbatohen propozimet që mund të tejkalojnë ose lehtësojnë disa sfida të paraqitura në këtë seancë të Komisionit. Ajo rikujtoi edhe mundësinë e mbajtjes së mbledhjeve të kryetarëve të këshillave nga secili rajon planifikues, siç është realizuar në periudhën paraprake, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe përcaktimin e propozimeve për përmirësimin e funksionimit të këshillave komunale.

Në seancë morrën pjesë edhe përfaqësuesit e UNDP-së, të cilët prezantuan qëllimet dhe aktivitetet e projektit ,,Përforcim i këshillave komunale – faza 2", që zbatohet në partneritet me BNJVL-në, përmes së cilës mund t'u jepet përkrahje të disa aktiviteteve të Komitetit të këshillave në kuadër të BNJVL-së. U përmend se përkrahja nga BNJVL është mjaft e rëndësishme për këshilltarët komunalë.

## ОБЕЗБЕДЕНИ СРЕДСТВА ЗА ПОДДРШКА НА ОПШТИНИТЕ ЗА АКТИВНОСТИТЕ ЗА ПОЧИСТ ВОЗДУХ И ЗА ИЗРАБОТКА НА ПРОЕКТНА ДОКУМЕНТАЦИЈА ЗА ИНФРАСТРУКТУРНИ ПРОЕКТИ

„Поддршката на општините, особено на помалите, за изработка и подготвување на техничка документација на проекти, е исклучително корисна, а предлозите за меѓусебна соработка на општините при изработка на документацијата за реализација на поголеми, регионални проекти, ЗЕЛС комплетно ги поддржува. Тоа ќе придонесе кон постигнување на поголема рамномерност во регионалниот развој, но пред сè подобар живот за сите граѓани. Во однос на проектните активности за справување со загадувањето на воздухот, што ќе се реализираат во пет општини: Гостивар, Куманово, Кавадарци, Струга и Струмица, предлагам да се воспостави заемна соработка меѓу овој проект и проектот за чист воздух што ќе го реализираат Градот Нирнберг и ГИЗ, во соработка со ЗЕЛС. Двата проекта, не само што се насочени кон поддршка на општините, туку индиректно ќе обезбедат подобар живот за граѓаните. Сакам да ве информирам дека ЗЕЛС , многу скоро ќе достави верзија на Предлог за измени на Законот за воздух, за што е информирана и новата министерка за животна средина и просторно планирање, со која неодамна имав средба".

Ова го истакна Душица Перишиќ, извршна директорка на ЗЕЛС, на конференцијата што на 29 март 2023 година се одржа во Скопје, во организација на УНДП и Шведската агенција за развојна соработка, а на која присуствуваа министрите за локална самоуправа и за животна средина и просторно планирање, високи

## U SIGURUAN MJETE PËR PËRKRAHJEN E KOMUNAVE PËR AKTIVITETET PËR AJËR MË TË PASTËR DHE PËRPILIMI I DOKUMENTACIONIT PROJEKTUES PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURORE

„Përkrahja e komunave, veçanërisht të komunave më të vogla për përpilimin dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik të projekteve, është tejet e dobishme, ndërsa propozimet për bashkëpunim të ndërsjellë të komunave gjatë përpilimit të dokumentacionit për realizim të projekteve më të mëdha rajonale, BNJVL i përkrah tërësisht. Kjo do të kontribuojë drejt arritjes së barazisë më të madhe në zhvillimin rajonal, por para se gjithash jetë më e mirë për qytetarët. Lidhur me aktivitetet e projektit për sigurimin e ajrit më të pastër, që do të realizohet në pesë komunat: Gostivar, Kumanovë, Kavadari, Struga dhe Strumica, propozoj të themelohet bashkëpunim i ndërsjellë midis këtij projekti dhe projektit për ajër të pastër që do të realizojnë qyteti Nuremberg dhe GIZ, në bashkëpunim me BNJVL-në. Të dy projektet jo vetëm që janë drejtuar drejt përkrahjes së komunave për sigurimin e mjedisit jetësor, por në mënyrë indirekte kontribuojnë për sigurimin e ajrit më të pastër për të gjithë. Dëshiroj t'ju informoj se BNJVL, shumë shpejtë do të parashtrojë version të Propozimit për ndryshim të Ligjit për ajër të pastër, për ç'arsye është informuar edhe ministrja e re për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, me të cilën pata takim para do kohë".

Këtë e theksoi Dusica Perishiq, drejtoreshë ekzekutive e BNJVL-së, në konferencën që u mbajt më 29 mars 2023 në Shkup, në organizim të UNDP-së dhe Agjencisë suedeze për bashkëpunim zhvillimor, ku morën pjesë ministrat për vetëqeverisje lokale dhe të mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor,

претставници од меѓународните организации присутни во земјава, претставници од Бирото за регионален развој и од општините. Министерот за локална самоуправа, Ристо Пенов, информираше дека е обезбедена поддршка од УНДП и од Шведската агенција за развојна соработка за изработка на проектна документација, како поддршка на општините коишто имаат ограничени човечки и финансиски ресурси и досега тешко се снаоѓале со подготовка на поголеми, инфраструктурни проекти што бараат обемна техничка документација, согласно со стандардите на големите финансиски институции како што се ЕУ, Светска банка и други. „Во процесот на интегрирање во Европската Унија, покрај усогласување на законодавството, треба да покажеме и капацитет за имплементирање на фондовите на Европската Унија, согласно со нивните правила“, нагласи Пенов.

Вкупната вредност на проектот „Јакнење на општинските капацитети за имплементација на проекти“ е 2,6 милиони долари, каде 500.000 долари се обезбедени од Бирото за регионален развој, а кофинасирањето, од околу 240.000 долари, се очекува да биде обезбедено од општините. За техничкиот фонд за изработка на проектна документација се наменети 1,5 милиони долари. Првиот повик за општините и за центрите за развој се очекува во април, оваа година. Двата проекта се реализираат како дел од Програмската рамка за соработка помеѓу Шведската агенција за меѓународна развојна соработка – Сида и УНДП во нашата земја.

përfaqësues të lartë nga organizatat ndërkombëtare të pranishme në vend, përfaqësues nga Byroja për zhvillimit rajonal dhe nga komunat. Ministri për vetëqeverisje lokale, Risto Penov, informoi se është ofruar mbështetje nga UNDP dhe Agjencia suedeze për bashkëpunim zhvillimor lidhur me përpilimin e dokumentacionit të projektit, si mbështetje për komunat që kanë burime të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe deri më tani kanë pasur vështirësi në përgatitjen e projekteve më të mëdha infrastrukturore, projekte që kërkojnë dokumentacion të gjerë teknik, në përputhje me standardet e institucioneve kryesore financiare si BE, Banka Botërore etj. “Në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, përveç harmonizimit të legjislacionit, duhet të demonstrojmë edhe kapacitetin për të zbatuar fondet e Bashkimit Evropian, në përputhje me rregullat e tyre”, theksoi Penov.

Vlera e përgjithshme e projektit ,,Përforcim i kapaciteteve komunale për implementimin e projekteve është” 2,6 milion dollarë, ku 500.000 dollarë sigurohen në Byronë për zhvillim rajonal, ndërsa kofinancimi, prej rreth 240.000 dollarë, pritet të sigurohen për komunat. Për fondin teknik për përpilimin e dokumentacionit të projektit janë dedikuar 1,5 milion dollarë. Thirrja e parë për komunat dhe për qendrat për zhvillim në prill të këtij viti. Të dy projektet realizohen si pjesë e Kornizës programore për bashkëpunim midis Agjencinë suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar – Sida dhe UNDP në vendin tonë.



## ОРГАНИЗИРАН НОВ ЦИКЛУС ОБУКИ И ПОЛАГАЊЕ ИСПИТ ЗА СТЕКНУВАЊЕ СО ЛИЦЕНЦА ЗА ВОДЕЊЕ НА ПОСТАПКА ЗА ОТУЃУВАЊЕ И ДАВАЊЕ ПОД ЗАКУП НА ДРЖАВНО ГРАДЕЖНО ЗЕМЈИШТЕ

ЗЕЛС, во соработка со Министерството за транспорт и врски, им излезе во пресрет на барањата на поголем број општини и обезбеди реализирање на нов циклус обуки и полагање испит на претставници од општинската администрација за стекнување со лиценца за водење на постапка за отуѓување и давање под закуп на градежно земјиште, сопственост на Република Северна Македонија. Интересот за обуките е голем од причина што повеќе општински службеници треба да ја обноват претходно стекнатата лиценца, која е во времетраење од пет години. Исто така, во некои од единиците на локалната самоуправа, дел од лиценцираните службеници заминуваат во пензија или на друго работно место, со што се нарушува потребниот број лица што во согласност со законските прописи, општината треба да го обезбеди, а некои општини вработуваат нови службеници во оваа област.

Во таа насока, во март, Комисијата за следење на процесот на организирање и спроведување обука и испит објави два огласа, на кои се пријавија вкупно 62 кандидати. Стручната служба на ЗЕЛС, по извршената проверка за исполнетост на условите на кандидатите, ги информираше пријавените за термините за следење на почетната обука. Пријавените кандидати на првиот оглас, објавен на 8 март 2023 година, практичната обука ја следеа на 28 март 2023 година во ЗЕЛС тренинг центарот. За кандидатите пријавени на вториот оглас, обука ќе се реализира на 10 април 2023 година. На почетната обука присутните се запознаа со законската регулатива од оваа област. Станува збор за една динамична материја проследена и со одредени измени во прописите, но истовремено и комплексна од аспект на имотноправните и другите постапки што треба да се спроведуваат.

Лицата што ја проследија почетната обука ќе имаат можност да го полагаат теоретскиот, а потоа и практичниот дел од испитот за што ќе бидат дополнително информирани. Полагањето се спроведува електронски, во Испитниот центар на Европскиот универзитет, а резултатите се објавуваат на веб-страницата на ЗЕЛС (www.zels.org. mk) веднаш по завршувањето на испитот.

## U ORGANIZUA CIKËL I RI I TRAJNIMEVE DHE PROVIMIT PËR MARRJEN E LICENCËS PËR UDHËHEQJE ME PROCEDURËN PËR TJETËRSIM DHE DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS NDËRTIMORE

BNJVL në bashkëpunim me Ministrinë për transport dhe lidhje u doli në vigjilje kërkesave të një numri të madh të komunave dhe siguroi realizimin e një cikli të ri të trajnimeve dhe provimit për përfaqësuesit e administratës komunale për marrjen e licencës për udhëheqjen e procedurës për tjetërsim dhe dhënie me qira të tokës ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Interesi për trajnimet është i madh edhe për arsye se ka gjithnjë e më shumë nëpunës që duhet të përtërijnë licencën e marrë, që është në kohëzgjatje prej pesë vitesh. Në disa prej njësive të vetëqeverisjes lokale, një pjesë e nëpunësve të licencuar shkojnë në pension ose në ndonjë vend tjetër të punës me ç'rast numri i duhur i personave të licencuar mbetet i mangët që komuna detyrimisht duhet t'a ketë konform dispozitave ligjore. Ose në komunat punësohen nëpunës të ri në këtë lëmi.

Në këtë drejtim në muajin mars, Komisioni për ndjekjen e procesit të organizimit dhe zbatimi i trajnimit shpalli dy konkurse, në të cilat janë paraqitur 62 kandidatë. Shërbimi profesional i BNJVL-së, pas kontrollit të kryer të plotësimit të kushteve të kandidatëve i informoi ata që paraqiten për terminët për ndjekjen e trajnimit fillestar. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike më 8 mars 2023 trajnimin praktik e ndoqën më 28 mars 2023 në Qendrën e trajnimeve të BNJVL-së. Për kandidatët e regjistruar në provimin e dytë, trajnimi do të zhvillohet më 10 prill 2023. Në trajnimin fillestar, të pranishmit njihen me legjislacionin në këtë fushë. Është një çështje dinamike e ndjekur nga ndryshime të caktuara në rregullore, por në të njëjtën kohë komplekse në aspekt të procedurave pronësore-juridike dhe procedura tjera që duhet të zbatohen.

Personat që kanë përfunduar trajnimin fillestar do të kenë mundësi të marrin pjesë në provimin teorik dhe më pas pjesën praktike, për të cilën do të informohen më tej. Provimi zhvillohet në mënyrë elektronike, në Qendrën e provimeve të Universitetit Evropian, ndërsa rezultatet publikohen në ueb faqen e BNJVL-së (www.zels.org. mk) menjëherë pas përfundimit të provimit.





## БРОЈНИ КОНТРАДИКТОРНОСТИ ВО ПРЕДЛОЖЕНИТЕ ИЗМЕНИ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕВОЗ ВО ПАТНИОТ СООБРАЌАЈ

Мрежата на инспектори за сообраќај, патишта и патен сообраќај при ЗЕЛС, на 30 март 2023 година, во просториите на ЗЕЛС, одржа работна средба на која се разгледуваше Предлогот за измени на Законот за превоз во патниот сообраќај, изработен од Министерството за транспорт и врски. Присутните, по обемната дискусија, утврдија многу забелешки кои прецизно ги наведоа во допис и тие ќе бидат разгледани на следната седница на Управниот одбор на ЗЕЛС .

Во дадените забелешки на претставниците на мрежата, од особена важност е нивната реакција на бришењето на членовите 22-б и 2-б од постојниот закон. Овие членови беа воведени пред околу пет години, токму на иницијатива на ЗЕЛС. Во нив стои дека бесплатниот превоз на учениците се врши со општински линиски или меѓуопштински линиски превоз на подрачјата каде што има утврден возен ред. Претставниците од мрежата нагласија дека треба да се разгледа ова прашање повторно и да се земат предвид сите последици што може да произлезат од бришењето на овие два члена, посебно од бришењето на 22-б за општинскиот линиски превоз со кој може да се врши превоз на ученици на подрачјата на општините. Присутните посочија дека во суштина треба да се остават можности за регулирање на начинот на превоз на ученици на секоја општина посебно, според можностите и потребите кои реално ги имаат училиштата, а кои се во контекст на добивање на економичен и квалитетен превоз на учениците.

Реакции беа изнесени и за одредбите со кои се регулира автотакси превозот на патници, околу предложеното намалување на бројот на седишта на возилото со кое може да врши ваков превоз, но и во однос на органичувањето на слегувањето на патниците само на едно место, по првичното качување во возилото. Присутните, исто така, посочија дека предвидениот услов за такси-превоз со возило со минимум Еуро 5 еколошки стандард е многу ригорозен, бидејќи мал број превозници би го исполниле овој услов, а со тоа ќе се поттикне нелегално вршење на автотакси превоз. Беше посочено дека е нелогично барањето на ваков стандард, ако се има предвид дека за меѓународен превоз се предлага возилото да има минимум Еуро 4 еколошки стандард. Освен за бројот на такси-возачите со кои компанијата задолжително треба да располага, беше нагласено дека треба да се утврди и задолжително поседување на сертификат за автотакси возач, а беа утврдени забелешки и во делот на возач почетник. Понатаму, беше нагласена потребата за обезбедување на координираност меѓу Законот за превоз во патниот сообраќај и Законот за возила, во однос на жолтите таблици за такси-возилата, бидејќи настануваат тешкотии во управните постапки кога службените лица се доведени во безизлезна состојба при донесувањето решенија. Одредени контрадикторности беа забележани и во други делови од Предлог-законот, особено во делот за прекршочните постапки, но и кај другите одредби. Па така, во членот 81 став 2 стои: „превозникот самостојно ја утврдува цената на превозот“, а во членот 79 став 1, алинеа 5 стои дека Советот на општината или Град Скопје

## KONTRADIKTA TË SHUMTA NË NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË LIGJIN PËR TRANSPORT NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

Rrjeti i inspektorëve për komunikacion, rrugë dhe komunikacion rrugor në kuadër të BNJVL-së më 30 mars 2023 në hapësirat e BNJVL-së mbajti takim në të cilin u shqyrtua Propozimi për ndryshim të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor, të përpiluar nga Ministria për transport dhe lidhje. Të pranishmit pas një diskutimi vëllimor përcaktuan shumë vërejtje të cilat në mënyrë precize i shënuan në shkresë dhe të njëjtat do të shqyrtohen në seancën e ardhshme të Bordit drejtues të BNJVL-së.

Në vërejtjet e dhëna të përfaqësuesve të Rrjetit në fjalë, rëndësi të dukshme ka edhe reagimi i tyre në shlyerjen e neneve 22-b dhe 27-b nga Ligji ekzistues. Këto nene janë prezantuar para rreth pesë vitesh, pikërisht me iniciativën e BNJVL-së. Ata thonë se transporti falas i nxënësve kryhet me linja komunale ose ndërkomunale në zonat ku ka orar të përcaktuar. Përfaqësuesit nga Rrjeti theksuan se kjo çështje duhet të rishikohet dhe të merren parasysh të gjitha pasojat që mund të lindin nga fshirja e këtyre dy neneve, veçanërisht nga fshirja e 22-b për transportin e linjës komunale, e cila mund të përdoret. për të kryer transportin e nxënësve në zonat e bashkive. Të pranishmit theksuan se në thelb, mundësitë për rregullimin e mënyrës së transportit të nxënësve duhet t'i lihen secilës komunë individualisht, sipas mundësive dhe nevojave që realisht kanë shkollat, të cilat janë në kuadër të sigurimit të transportit ekonomik dhe cilësor të nxënësve.

Reagime ka pasur edhe për dispozitat që rregullojnë transportin e udhëtarëve e me autotaksi, për sa i përket uljes së propozuar të numrit të vendeve në mjetin që mund të kryejë këtë lloj transporti, por edhe në lidhje me organizimin e zbritjes së udhëtarëve vetëm me një vend, pas hipjes fillestare në mjet. Të pranishmit po ashtu theksuan se kushti i paraparë për taksi - transport me automjet me standard minimal mjedisor Euro 5 është shumë rigoroz, sepse një numër i vogël transportuesish do t’a plotësonin këtë kusht dhe në këtë mënyrë do të inkurajohej praktika e kundërligjshme e transportit me autotaksi. U theksua se është e palogjikshme të kërkohet një standard i tillë, duke qenë se për transportin ndërkombëtar sugjerohet që automjeti të ketë standard mjedisor minimal Euro 4. Përveç numrit të taksistëve që duhet të ketë kompania, u theksua se duhet të përcaktohet posedimi i detyrueshëm i çertifikatës së shoferit të autotaksisë, si dhe u bënë vërejtje edhe për pjesën e shoferit fillestar. Po ashtu, u theksua nevoja për të siguruar koordinim ndërmjet Ligjit për komunikacion rrugor dhe Ligjit për automjete, sa i përket tabelave të verdha për taksitë, për shkak se vështirësitë në procedurat administrative lindin kur personat zyrtarë çohen në situatë që s’ka rrugëdalje gjatë marrjes së vendimeve. Kontradikta të caktuara janë vërejtur edhe në pjesët tjera të Propozimit të Ligjit, veçanërisht në pjesën e procedurave për kundërvajtje, por edhe në dispozita të tjera. Kështu në nenin 81 paragrafi 2 thotë se ,,transportuesi në mënyrë të pavarur përcakton çmimin e transportit”, ndërsa në nenin 79 paragrafi 1 alinea 5 qëndron se Këshilli i komunës ose Qyteti i





утврдува „тарифи за вршење на автотакси превоз во рамките на општината, тарифи за вршење на автотакси превоз кон друга општина или градот Скопје“. Овие две работи се контрадикторни и предлагачот на Законот треба да дообјасни што е суштината или да го избрише членот 81.

Присутните посочија дека треба да се направи исправка во називот на инспекторите, односно наместо предложеното „овластен инспектор на општината и Град Скопје, да се стави , „општински инспектор“ , во согласност со Законот за инспекциски надзор и називот што стои во лиценците за инспектори, издадени од Инспекцискиот совет. Како недопуслива деградација, членовите на мрежата го посочија делот со прекршочните одредби за правно или физичко лице – трговец поединец, кога одредбата „на инспекторот за патен сообраќај не му овозможува вршење на инспекциски надзор, не му дава потребни известувања и не му ја става на увид потребната документација“ е категоризирано како „помал прекршок“. За ова дело во измените е предвидена глоба од 15 евра, наспроти 50 евра глоба предвидена во постојниот Закон. Со тоа се деградира институцијата инспектор и предложената одредба претставува мотивација за нелегално вршење на превоз на патници.

## ОТВОРЕН ЈАВЕН ПОВИК ЗА ГРАДОВИ И ОПШТИНИ ОД ЗЕМЈИТЕ ОД ЈИЕ ЗА СТЕКНУВАЊЕ СО BFC SEE-СЕРТИФИКАТ

Сите единици на локалната самоуправа во нашата земја кои имаат активен пристап во обезбедување услови за развој на инвестиции и унапредување на деловниот амбиент на својата територија и кои сакаат воведување на меѓународни стандарди за ефикасна и транспарентна локална администрација, во согласност со принципите на добро владеење имаат можност да се вклучат во меѓународната BFC SEE-програма за сертификација на градови и општини со поволно деловно опкружување во Југоисточна Европа (Business Friendly Certification South East Europe - BFC SEE). BFC SEE-стандардот дава јасни насоки за зачувување на вработеноста и отворање работни места преку јакнење на партнерството со локалната деловна заедница. Критериумите ги следат развојните и просторни планови и помагаат да се унапреди организацискиот капацитет, ефикасноста и нивото на дигитализација на општинските услуги. Стандардот ја рангира и конкурентноста во поглед на локалните давачки и особено ја вреднува поддршката на претприемништвото, иновациите и зелената економија. Досега, во нашата земја процесот на BFC SEE-сертификација го минаа општините: Богданци, Велес, Гази Баба, Илинден, Струмица, Штип и Град Скопје.

ЗЕЛС, како акредитиран технички секретаријат во нашата земја, во рамките на платформата „Партнерство за конкурентен регион“ (CORE) (единствена платформа со над

Shkupit përcakton ,,tarifat për kryerjen e transportit me auto-taksi në kuadër të komunës, tarifave për kryerjen e transportit të auto-taksisë ndaj komunës tjetër ose Qytetit të Shkupit. Këto dy punë janë kontradiktore dhe propozuesi i Ligjit të qartësojë se çka është thelbi ose të shlyhet neni 81.

Të pranishmit përmendën se duhet të bëhet korrigjim në titullin e inspektorëve, respektivisht në vend të këtij titulli të propozuar ,,inspektor të autorizuar të komunës dhe Qytetit të Shkupit, të vendoset, inspektor komunal”, konform Ligjit për mbikëqyrje inspektive edhe titulli që qëndron në licencat për inspektorët, të dorëzuara nga Këshilli inspektiv. Si degradim të papranueshëm, anëtarët e Rrjetit theksuan pjesën e dispozitave penale për personin juridik ose fizik - tregtar individual, kur dispozita nuk e lejon inspektorin e qarkullimit rrugor të kryejë kontrolle, nuk i jep njoftimet e nevojshme dhe nuk i jep në këqyrje, dokumentacionin e nevojshëm kategorizohet ,,si kundërvajtje e vogël”. Për këtë vepër në të kaluarën është parashikuar gjobë prej 15 eurosh, kundrejt 50 euro gjobë të parashikuar në Ligjin ekzistues. Me këtë degradohet institucioni inspektor dhe dispozita e propozuar paraqet motivim për kryerjen ilegale të transportit me udhëtar.

## THIRRJE E HAPUR PËR QYTETET DHE KOMUNAT NGA VENDI DHE NGA EJL PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS BFC SEE

Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në vendin tonë të cilat kanë qasje aktive në sigurimin e kushteve për zhvillim të investimeve dhe avancimit të ambientit të biznesit në territorin e tyre dhe të cilët dëshirojnë themelimin e standardeve ndërkombëtare për një administratë lokale efikase dhe transparente, konform parimeve për qeverisje të mirë kanë mundësi të inkuadrohen në programin ndërkombëtar BFC SEE për certifikimin e qyteteve dhe komunave me ambient të favorshëm për biznes në Evropën Juglindore (Business Friendly Certification South East Europe - BFC SEE). Standardi BFC SEE ofron udhëzime të qarta për ruajtjen e punësimit dhe krijimin e vendeve të punës duke përforcuar partneritetet me bashkësinë e biznesit lokal. Kriteret ndjekin planet zhvillimore dhe hapësinore dhe ndihmojnë në përmirësimin e kapaciteteve organizative, efikasitetit dhe nivelit të dixhitalizimit të shërbimeve komunale. Standardi gjithashtu rendit konkurrencën për sa i përket taksave vendore dhe vlerëson veçanërisht mbështetjen e sipërmarrjes, inovacionit dhe ekonomisë së gjelbër. Deri më tani certifikatë BFC SEE morrën Qyteti i Shkupit, Velesi, Strumica, Shtipi, Ilindeni, Gazi Baba dhe Bogdanci.

BNJVL, si sekretariat i akredituar teknik në vendin tonë, në kuadër të platformës ,,Partneritet për rajon konkurrues" (CORE) (platformë unike me mbi 20 institucione dhe




20 институции и организации од регионот на Југоисточна Европа што овозможува регионална соработка и размена на знаења) објави оглас со кој ги повикува сите заинтересирани општини да се вклучат во процесот на стекнување на меѓународниот сертификат BFC SEE . Овој повик е ексклузивно отворен за 50 градови и општини од Југоисточна Европа кои досега не учествувале во програмата на BFC SEE, а општините може да се пријавуваат сè до исполнувањето на оваа бројка. Јавниот повик е поставен на веб-страницата на ЗЕЛС (https://zels.org.mk/newsd/5150) каде што се дадени и подетални информации за тоа што опфаќа BFC SEE-програмата; кои се нејзините предности, кои се досегашните најчести мотиви за учество на општините; која е користа за општината од поседувањето на овој сертификат, кои се критериумите што една општина треба задолжително да ги исполни за да се најде меѓу најуспешните општини во регионот и многу други прашања што би си ги поставила секоја општина пред да се пријави.

За да се стекне со сертификатот, секоја општина треба да исполни најмалку 75 % од 10-те ревидирани критериуми, во кои има вкупно 68 поткритериуми, утврдени во новата 4. едиција на стандардот. Општините што ќе се пријават за сертификација ќе добијат и Прирачник за сертификација на градови и општини со поволно деловно опкружување во Југоисточна Европа. Со развој на BFC SEE-платформата (www.bfc-see.org), поддржана од Советот за регионална соработка (RCC) и Отворениот фонд за модернизација на општински услуги (GIZ ORF MMS), овозможена е и автоматизација на целокупниот процес на сертификација што ќе трае 12 месеци. BFC SEE- сертификатот има важност од три години, по што општината може да влезе во процес на ресертификација.

ЗЕЛС, со цел на своите членки да им даде дополнителни информации за деталите и условите за учество во програмата, на 11 април 2023 година во своите административни простории, ќе организира мастер клас за сите градоначалници, а на 19 април 2023 година, во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот ќе организира информативна сесија: „Како до меѓународен BFC SEE-сертификат“, наменета за претставниците од општинската администрација.

organizata nga rajoni i Evropës Juglindore që mundëson bashkëpunim rajonal dhe shkëmbim të njohurive) shpalli konkurs me të cilin fton të gjitha komunat e interesuara të përfshihen në procesin e marrjes së certifikatës ndërkombëtare BFC SEE. Kjo thirrje është ekskluzivisht e hapur për 50 qytete dhe komuna nga Evropa Juglindore që akoma nuk kanë marrë pjesë në programin BFC SEE dhe komunat mund të aplikojnë derisa të plotësohet ky numër. Thirrja publike është postuar në ueb-faqen e BNJVL-së (https://zels.org.mk/newsd/5150) ku jepen informacione më të detajuara se çfarë mbulon programi BFC SEE; cilat janë avantazhet e tij, cilat janë motivet më të shpeshta për pjesëmarrjen e komunave deri më tani; cili është përfitimi i komunës nga posedimi i kësaj certifikate, cilat janë kriteret që duhet të plotësojë një komunë për të qenë ndër komunat më të suksesshme në rajon dhe shumë pyetje të tjera që çdo komunë do t'ia parashtronte vetes përpara se të aplikonte.

Për të marrë certifikatën, çdo komunë duhet të plotësojë të paktën 75% të 10 kritereve të rishikuara, në të cilat janë gjithsej 68 nënkritere, të përcaktuara në edicionin e ri të katërt të standardit. Komunat që aplikojnë për certifikim do të marrin gjithashtu një Doracak për certifikimin e qyteteve dhe komunave me mjedis të favorshëm biznesi në Evropën Juglindore. Me zhvillimin e platformës BFC SEE (www.bfc-see.org), të mbështetur nga Këshilli për bashkëpunim rajonal (RCC) dhe Fondi i hapur për modernizimin e shërbimeve komunale (GIZ ORF MMS), është mundësuar automatizimi i të gjithë procesit të certifikimit është që do të zgjasë 12 muaj. Certifikata BFC SEE është e vlefshme për tre vjet, pas së cilës komuna mund të hyjë në procesin e ricertifikimit.

BNJVL, me qëllim që anëtareve të saj t’u ofrojë informacione plotësuese për detajet dhe kushtet për pjesëmarrje në programin në fjalë, më 11 prill 2023 në hapësirat administrative të saj do të organizojë master-klas për të gjithë kryetarët e komunave, ndërsa më 19 prill 2023, në hapësirat e Qendrës së trajnimeve të BNJVL-së do të organizojë sesion informativ: ,,Si të arrihet drejt certifikatës ndërkombëtare BFC SEE“, të dedikuar për përfaqësuesit e administratës komunale.

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT




**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**

тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994
ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**

tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk